POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Po pe një gazetar të pasur...
2 Historia vazhdon! Anne Hathaway jep lajmin e mirë për admiruesit e filmit ikonik: 'The Princess Diaries 3' po ecën në drejtimin e duhur
3 Botërori 2026/ Spektakli i Botërorit në versionin 'Super-Bowl', shkelet protokolli i FIFA-s! Tifozët vërshëllejnë Trump e Infantino-n
4 Nga 150 familje në 70, vijon braktisja e fshatit Lusën në Kukës, shkak rruga e shkatërruar dhe mungesa e ujit të pijshëm
5 Zjarr përgjatë autostradës Fier-Vlorë, flakët përfshijnë rreth 2 kilometra në anë të rrugës (VIDEO)

Kronikë

# Do shiste tritol e granata, arrestohet 52-vjeçari në Tiranë! VIDEO kur policia e shtrin në tokë dhe i vë prangat

*I arrestuari Petrit Çeça, banues në Fushë-Krujë, rezulton me precedentë të mëparshëm penalë në fushën e narkotikëve. Ai u ndalua në rrugën "Kastriotët", pasi u ndoq nga policia, te cilët e shtrinë në tokë për t'i vënë prangat*

Pamjet e arrestimit! Policia kap 52-vjeçarin që do të shiste tritol dhe g
Report TV

Watch on

Redaksia
20 Korrik, 09:45 | **Përditesimi: 20 Korrik, 10:04**

Share Post

Një 52-vjeçar është arrestuar në Tiranë, pasi u kap duke transportuar granata luftarake, tritol dhe kapsolla detonatore, të cilat dyshohet se do t'i shiste. Sipas Policisë, i arrestuari Petrit Çeça, banues në Fushë-Krujë, rezulton me precedentë të mëparshëm penalë në fushën e narkotikëve. Ai u ndalua në rrugën "Kastriotët", pasi u ndoq nga policia, te cilët e shtrinë në tokë për t'i vënë prangat siç shihet edhe në pamje.

Gjatë kontrollit, policia gjeti dhe sekuestroi 2 granata dore luftarake, 2 ndezës granatash, 600 gramë lëndë plasëse (tritol), një pjesë e së cilës ishte e pajisur me 2 fitila dhe 2 kapsolla detonatore gati për shpërthim, si edhe 6 kapsolla detonatore.

> *"Si rezultat i informacioneve të siguruara në rrugë operative, shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", në bashkëpunim me Sektorin e Forcës së Posaçme Operacionale dhe Seksionin për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Porosia". Gjatë operacionit, në rrugën "Kastriotët", u kap dhe u vu në pranga shtetasi P. Ç., 52 vjeç, banues në Fushë-Krujë, me precedent të mëparshëm penal në fushën e narkotikëve.*



LEXO EDHE:
***'Ethet' e finales së Botërorit, tifozët 'pushtojnë' Fan Zone në sheshin 'Skënderbej' (VIDEO)***

> *Gjatë kontrollit të qeses që mbante me vete, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, 2 granata dore luftarake, 2 ndezës unifikues, 600 gramë lëndë plasëse (tritol), një pjesë e së cilës ishte e pajisur me 2 fitila dhe 2 kapsolla detonatore gati për shpërthim, si dhe 6 kapsolla detonatorë", njofton policia.*

Policia po vijon hetimet për të zbardhur origjinën e lëndëve plasëse dhe për të identifikuar personat që mund të jenë të përfshirë në këtë rast.

-------------------------------
**Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë**

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Tirane Petrit Ceca tritol granate

Komento

## Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 20 Korrik, 07:09
**Territorialja, si e vlerësoni propozimin e PS për më pak bashki dhe ndarje në rajone?**

I drejtë | I gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera


Protesta vijon në ditën e 50-të, venitet pjesëmarrja! Marshimi zgjat më pak se çdo herë tjetër (VIDEO)
19 Korrik, 20:39


Ekzekutimi i 50-vjeçarit në Bërxullë, burime: Viktima bashkëaksioner në një kompani për kanabisin mjekësor në Maqedoni! Pistë hetimi edhe dhënia e parave me fajde
Sokol Dema
19 Korrik, 11:36


Degjeneron fjalori në protestë, i riu në podium: Ne duam të hamë, të pimë dhe të q*** (VIDEO)
18 Korrik, 21:36


Më të paktë në numër, qytetarët në protestë për të 49-ën ditë! Organizatorët kundër mbledhjes së 'Kuvendit Kombëtar': Përfaqësuesit janë në shesh
18 Korrik, 20:25


Kapet në Rinas egjiptiani 34-vjeçar, dyshohet se trafikonte emigrantë të paligjshëm
18 Korrik, 12:05


Shisnin veshje dhe çanta luksoze të kontrabanduara, vihen nën hetim 9 administratorët e 8 subjekteve në Tiranë (VIDEO)
18 Korrik, 10:53


Garat në Tiranë dhe Shkodër – analizë paraprake
Eduard Zaloshnja
17 Korrik, 20:23


Protesta në ditën e 48-të, zbehet dukshëm pjesëmarrja (VIDEO)
17 Korrik, 20:16


Shkolla Verore 2026/ Ndahen vlerësime për gjimnazistët vullnetar, Kumbaro: Kontributi i vyer për shkollat dhe një përvojë e vlefshme për të rinjtë!
17 Korrik, 13:12


U përjashtua nga gara për kreun e PD/ Mereme Sela nuk heq dorë, dërgon në Apel vendimin e pushimit të ankimimit të saj nga Gjykata e Shkallës së Parë
17 Korrik, 09:47


Performoi Kanye West, Gonxhja publikon pamjet nga ndërtimi i 'Eagle Stadium': Transformimi i terrenit, ngritja e skenës dhe tribunave u realizua në kohë rekord
17 Korrik, 09:33


E moshuara sulmon SPAK gjatë protestës para Kryeministrisë: Altin Dumani është për burg! Ka mbrojtur hajdutët dhe ka dënuar njerëzit e ndershëm
16 Korrik, 20:33






Lajmi i fundit
Po pe një gazetar të pasur...
20 Korrik, 19:32 nga Ardi Stefa

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit




Po pe një gazetar të pasur...

20 Korrik, 19:32 nga Ardi Stefa

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com